



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05/02

Dt. 06/01/2020

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit shpallë:

Konkurs për plotësimin e vendeve të punës

I. Pozita: Punëtor teknik

Vendi i punës: SHFMU "Elfir Behrami" në Metehi, një (1) punëtor teknik

Paga: 272.88 €

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit me mundësi të vazhdimit

Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për rregullimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për rregullimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Certifikata e lindjes
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin
- Certifikatën që nuk jeni në hetime (jo më më të vjetër se 6(gjashtë)muaj.
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen pas publikimit të rezultateve)
- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve) në objektin e ri të Komunës, rr. "Nuhi Gashi" Podujevë.

Afati i konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 dite kalendarike, nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, ne tabelen e shpalljeve në objektin e komunes dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 21.01.2020.



Drejtori i DKA-së
Agim Blakçori